

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëria Springtide Ventures s.r.o. me seli të regjistruar në Evropska 866/71, Vokovice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke dhe Trikvetra AG me seli të regjistruar në Landshtrese 99, 9494 Shan, Lihtenshtajn, e dorëzuar përmes Ognen Martinov, avokat nga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 08.11.2023, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Springtide Ventures s.r.o. me seli të regjistruar në Evropska 866/71, Vokovice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke dhe Trikvetra AG me seli të regjistruar në Landshtrese 99, 9494 Shan, Lihtenshtajn, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi InStar Technoxhis a.s. me seli në Mrshtikova 399/2a, Liberec III – Jerzhab, 460 07 Liberec, Republika Çeke, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligjit) më 16.10.2023, e plotësuar më 25.10.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga Springtide Ventures s.r.o. me seli të regjistruar në Evropska 866/71, Vokovice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke dhe Trikvetra AG me seli të regjistruar në Landshtrese 99, 9494 Shan, Lihtenshtajn, me anë të secilit

Springtide Ventures s.r.o. dhe Trikvetra AG do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi InStar Technoxhis a.s. me seli në Mrshtikova 399/2a, Liberec III – Jerzhab, 460 07 Liberec, Republika Çeke.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-Springtide Ventures sr.o. është një kompani përgjegjëse për identifikimin e mundësive të investimeve në kapitalin sipërmarrës dhe mirëmbajtjen dhe menaxhimin e investimeve të tilla, duke u fokusuar në start-up-et teknologjike. Të gjitha aktivitetet e tjera, kryesisht shërbimet konsulente, janë vetëm ndihmëse, p.sh. dhënia me qira e pronave të paluajtshme, hapësira banesore dhe tregtare, ndërmjetësim në tregti dhe shërbime për ofrimin e softuerit, konsulentë në fushën e teknologjisë së informacionit, përpunimit të të dhënave, pritjes dhe aktiviteteve të ndërlidhura dhe portaleve ueb, aktivitete këshillimore dhe këshilluese, përgatitja e opinioneve profesionale. Kompania është një degë 100% e KKCG Tehnologies sr.o. e cila kontrollohet në mënyrë indirekte nga KKCG AG. KKCG AG është një kompani holding që merr përsipër dhe menaxhon pjesët në kompanitë e portofolit. Grupi KKCG AG është një grup privat investimesh i përfaqësuar në fushat e mëposhtme:

- lotari dhe argëtim: punë lotarie dhe lojëra bastesh, gërvishtje dhe platforma lojërash online;
- energji: në veçanti, kërkime dhe prodhim, shpime dhe shërbime, ruajtje të energjisë, tregti, furnizim dhe energji rinovuese;
- teknologji: ofrimi i shërbimeve IT, investimet në startup-et teknologjike dhe kërkimin dhe zhvillimin („I dhe R“) dhe shitjen e pajisjeve inovative mjekësore për të ndihmuar pacientët të mbeten aktivë dhe të vetë-mjaftueshëm (bioteknologji); dhe
- pasuritë e paluajtshme: zhvillimi komercial dhe rezidencial.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG AG është i pranishëm në treg për të punuar me терминалет për video lotari dhe teknologjitë e informacionit përmes kompanive të mëposhtme:

-Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MACEDONIJA SHPK Shkup, me seli në Bulevardib Kiro Gligorov nr.2 Shkup, Gazi Babë me veprimtari prioritar - lojërat e fatit dhe basteve;

-Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit të Video-lotarisë shtetërore të Republikës së Maqedonisë

- KASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Kiro Gligorov nr.2 Shkup, Gazi Babë me aktivitet prioritar - lojërat e fatit dhe basteve;

- Kinshift SHPKNJP Shkup, më parë i njohur si Seavus SHPKNJP Shkup, me seli në 11 Tetor nr. 33A, Qendër 1, Shkup, me aktivitet prioritar - programim kompjuterik;

- Shoqëria edukative Seavus- Qendër edukative dhe zhvillim SHPK Shkup, me seli në 11 tetor nr. 33A, Qendër 1, Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër i pa përmendur diku tjetër dhe

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup me seli në Filip Vtori Makedonski nr.3/kati 4 zyre nr.4003 Shkup - me aktivitet prioritar - programim kompjuterik.

-**Trikvetra AG** është vetëm një kompani Holding për InStar dhe nuk ka aktivitete të tjera.

-**InStar Tehnoloxhis a.s.** është një kompani çeke biofarmaceutike me një teknologji unike të patentuar për shfrytëzimin e shpërndarjes oromukoze të substancave aktive. InStar a.s. është aktive në tregun e

filmit të hollë oral duke mundësuar shpërndarjen oromukozale të substancave aktive duke filluar nga molekulat e vogla deri te peptidet, proteinat dhe antigenet e vaksinave.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски